



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr.483, datë 14.10.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË PIKËN “2 GËRMA b” TË VENDIMIT TË KOMISIONIT
KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 518, datë 21.12.2021 “PËR LICENCIMIN E SH.A
UJËSJELLËS KANALIZIME BERAT-KUÇOVË”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (**VKM nr. 958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr.29, datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 14.10.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit “Për një ndryshim në pikën 2 germa b, të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr.518, datë 21.12.2021“Për Licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë”.

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë (UK Berat-Kuçovë) me shkresën nr.968 prot. datë 21.09.2022, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë” ka paraqitur pranë ERRU kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Berat-Kuçovë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Berat-Kuçovë me vendimin nr.518, datë 21.12.2021“Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë”, me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuese teknike e shoqërisë UK Berat-Kuçovë sh.a. Znj. Evis Allajbe ka mbaruar studimet e larta në inxhinieri Hidroteknikë në vitin 2004.
5. ERRU në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Berat-Kuçovë sh.a të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM nr. 958 dhe Rregullores së Licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Berat-Kuçovë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën “2 b” të vendimit të KKRR nr.518, datë 21.12.2021“Për licencimin e sh.a Ujësjiellës Kanalizime Berat-Kuçovë”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues Teknik Evis Allajbe ”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani